



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Agjencia kundër Korrupsionit
Agencija protiv Korupcije / Anti-Corruption Agency

RAPORT

ANALIZË MBI NDJEKJEN
DHE GJYKIMIN E RASTEVE
KORRUPTIVE NË KOSOVË

Prishtinë, Qershor 2012

Përmbajtja:

HYRJE	2
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	2
POLICIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS.....	4
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS	6
DOGANAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS.....	7
PROKURORIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS.....	7
GJYKATAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS	9
ANALIZA	12
KONKLuzionET	17
MËSIMET DHE REKOMANDIMET	17
LISTA E TABELAVE:	18

Hyrje

Niveli i korrupsionit në Kosovë vazhdon të jetë një preokupim i dukshëm i shoqërisë në përgjithësi. Kosova i ka bërë disa hapa në drejtim të luftimit dhe parandalimit të dukurisë së keqe e quajtur korrupsion. Kosova ka hartuar një kuadër ligjor kompatibil me standardet ndërkombëtare dhe ka themeluar të gjitha institucionet e nevojshme për ta luftuar atë.

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) si një mekanizëm qendror që ka mandat Parandalimin dhe Luftimin e korrupsionit me Ligjin për Agjencinë kundër Korrupsionit (Ligji nr.03/L-159) në nenin 5 pika 1.14 ka kompetencë që të mbledhë, analizon dhe publikon të dhënat statistikore ose të dhëna të tjera në lidhje me gjendjen e korrupsionit në Kosovë. Si rezultat i kësaj bashkë me të dhënat e Agjencisë janë mbledhur të dhënat statistikore të rasteve të dyshuara korruptive edhe nga institucionet tjera relevante që kanë për detyrë ligjore hetimin dhe ndjekjen e veprave penale me **natyrë korruptive, si Policia e Kosovës, Doganat, Administrata Tatimore e Kosovës, Prokuroritë dhe Gjykatat.**

Ky raport me këto të dhëna statistikore të cilin e realizon Agjencia si i tillë do t'iu shërbej të gjithë atyre që janë të interesuar të din përkitazi me atë, se sa po luftohet korrupsioni në Kosovë.

Raporti përmbledhë saktë të dhënat statistikore në lidhje me atë se si institucionet që kanë për mision luftën kundër korrupsionit i'u kanë qasur këtij problemi dhe se si ato i kanë trajtuar dhe ndjekur kryerësit e veprave korruptive apo edhe dënuar ata.

Pjesët në vijim përqendrohen në pasqyrimin e punës për vitin 2011 të Agjencisë kundër Korrupsionit, Doganave, Administratës Tatimore të Kosovës, Policisë së Kosovës, Prokurorive dhe Gjykatave të Republikës së Kosovës, në aktivitetet që këto institucione kanë zhvilluar në ndjekje të veprave penale me karakter korruptiv.

Agjencia kundër Korrupsionit

AKK procedurën e hetimit paraprak për rastet e dyshuara për korrupsion e ka zhvilluar në mbështetje të kapitullit XXIX të Kodit Penal të Kosovës; - veprat penale kundër Detyrës Zyrtare si dhe në Kapitullin XXII të Kodit Penal të Kosovës; - veprat penale kundër Ekonomisë.

Në vitin 2011, AKK ka pranuar shumë informata për dyshime se persona të caktuar mund të jenë përfshirë në veprime korruptive. Në 160 raste AKK ka gjetur elemente bazë për fillimin e hetimeve ndaj tyre. Ndërsa pas përfundimit të procedurave hetimore paraprake AKK ka konstatuar se prej 160 rasteve të raportuara për korrupsion në 39 ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë vepër penale.

Në këto 39 raste ku përfshihen 121 persona AKK ka ngritur kallëzime penale dhe të njëjtat i ka përcjellë tek Policia e Kosovës dhe Prokuroritë kompetente për procedim të mëtutjeshëm për këto vepra të dyshuara korruptive.

Ndërsa, në 5 raste pas përfundimit të procedurave hetimore paraprake është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë vepër penale, por është dyshuar për shkelje administrative, dhe Agjencia këto raste i ka përcjell në organet kompetente administrative me kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore.

1. Shpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit

Bazuar në nenin 339 të Kodit Penal të Kosovës, AKK ka përcjell në Policinë e Kosovës shtatë (7) raste ku janë përfshirë trembëdhjetë (13) persona, ndërsa në prokurorit kompetente vendore dhe të EULEX-it janë përcjell 26 raste, ku janë të përfshirë 95 persona. Numri total i rasteve që janë përcjell në Polici dhe Prokuroritë e Kosovës dhe të EULEX-it është 33 raste, derisa në to janë të përfshirë 108 persona nën dyshimin se kanë bërë vepër penale: shpërdorim i pozitës zyrtare dhe autorizimit.

2. Nxjerrja e kundërligjshme e Vendimeve Gjyqësore

Duke u mbështetur në nenin 346 të Kodit Penal të Kosovës, AKK ka përcjell një (1) rast në Policinë e Kosovës ku i përfshirë është një (1) person dhe një (1) rast në prokurori ku janë të përfshirë dy (2) persona nën dyshimin e marrjes së kundërligjshme të vendimit gjyqësor.

3. Arkëtimi dhe pagesa e paligjshme

Sipas nenit 349 të Kodit Penal të Kosovës AKK ka përcjell në prokurori një (1) rast, ku janë të përfshirë dy (2) persona nën dyshimin se kanë kryer vepër penale, - arkëtim dhe pagesë të paligjshme.

4. Shmangia nga Tatimi

Sipas nenit 249 të KPK-së, AKK ka përcjell një (1) rast në Policinë e Kosovës ku si të dyshuar janë përfshirë katër (4) persona.

5. Vjedhja

Bazuar në nenin 252 të KPK-së, AKK ka përcjell në Policinë e Kosovës për procedim penal të mëtutjeshëm një (1) rast, ku janë të përfshirë tre (3) persona.

6. Mashtrimi në detyrë

Si vepër penale Mashtrimi në detyrë e paraparë në nenin 341 të KPK-së, AKK ka përcjell në prokurori një (1) rast, me 1 person të dyshuar.

Tabela në vazhdim (*Tabela 1*) pasqyron të dhënat e sakta të denoncimeve të AKK-së në Polici dhe kallëzimet penale në Prokuroritë e Kosovës.

Agjencia kundër Korrupsionit					
Lloji i veprës	Neni i Kodit Penal të Kosovës	Numri i rasteve të përcjella në Polici	Numri i rasteve të përcjella në Prokurori	Gjithsejtë Raste	Gjithsejtë Persona
Shmangia nga Tatimi	249	1		1	4
Vjedhja	252	1		1	3
Mashtrimi në detyrë	341		1	1	1

Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit	339	7	26	33	108
Nxjerrja e Kundërligjshme e Vendimeve Gjyqësore	346	1	1	2	3
Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme	349		1	1	2
Gjithsejtë:		10	29	39	121

Tabela 1. Të dhënat statistikore për rastet e hetuara për korrupsion dhe të përcjella në organet kompetente për procedim të mëtutjeshëm penal nga Agjencia kundër Korrupsionit

Për më tej, AKK me legjislacionin dytësor e ka të rregulluar mënyrën e trajtimit të rasteve nga momenti i pranimit të informacionit nga qytetari deri te përcjella e rastit në prokurori apo edhe hedhja dhe mbyllja e rastit si i pabazuar.

AKK ka një raport të mirë komunikimi me Prokurorin e shtetit dhe në shumicën e rasteve AKK e merr informacionin kthyes për rastet (kallëzimet penale që ajo i paraqet në prokurori).

AKK e njofton qytetarin (raportuesin) për çdo hap që merret në raport me rastin e raportuar.

Policia e Republikës së Kosovës

Policia e Republikës së Kosovës gjegjësisht Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit nga informatat që i ka pranuar gjatë vitit 2011 ka punuar në gjithsejtë njëqind e pesëdhjetë e një (191) raste të dyshuara për vepra korruptive. Prej këtyre 191 rasteve, 40 raste janë nën hetime dhe 151 raste janë dërguar në Prokurori me kryes të njohur. Po ashtu Policia ka ushtruar kallëzime penale ndaj 293 personave të dyshuar.

Policia e Kosovës ka punuar në 191 raste sipas këtyre veprave penale:

1. Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit

Sipas nenit 339 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Tridhjetë e dy (32) raste nën hetime,
- Njëqind e katër (104) raste i ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, dhe
- Kundër dyqind e dymbëdhjetë (212) personave ka ushtruar kallëzim penal.

2. Përvetësim Gjatë Ushtrimit të Detyrës

Sipas nenit 340 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Gjashtë (6) raste nën hetime,
- Shtatë (7) raste i ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, dhe
- Kundër njëzet e gjashtë (26) personave ka ushtruar kallëzim penal.

3. Përdorim i paautorizuar i pasurisë

Sipas nenit 342 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Një (1) rast e ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, dhe
- Kundër një (1) personi ka ushtruar kallëzim penal.

4. Marrja e Ryshfetit

Sipas nenit 343 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Një (1) rast nën hetime,
- Njëzet e tre (23) raste i ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, dhe
- Kundër tridhjetë e tre (33) personave ka ushtruar kallëzim penal.

5. Dhënia e Ryshfetit

Sipas nenit 344 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Dhjetë (10) raste i ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, dhe
- Kundër trembëdhjetë (13) personave ka ushtruar kallëzim penal.

6. Ushtrimi i Ndikimit

Sipas nenit 345 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Një (1) rast nën hetime

7. Zbulimi i fshehtësive zyrtare

Sipas nenit 347 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

Një (1) rast e ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, dhe Kundër një (1) personi ka ushtruar kallëzim penal.

8. Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare

Sipas nenit 348 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Katër (4) raste i ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, dhe
- Kundër pesë (5) personave ka ushtruar kallëzim penal.

9. Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme

Sipas nenit 349 të Kodit Penal të Kosovës, Policia e Kosovës ka:

- Një (1) rast e ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur, dhe
- Kundër dy (2) personave ka ushtruar kallëzim penal.

Për të gjitha llojet e veprave penale të lartpërmendura Policia e Kosovës gjegjësisht Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe kundër Korrupsion ka hetuar 191 raste dhe ka ngritur kallëzim penal ndaj 293 personave. Prej 191 rasteve të lartpërmendura, 151 i ka dërguar në Prokurori me kryerës të njohur dhe 40 të tjera janë nën hetime.

Këto të dhëna statistikore janë paraqitur edhe në tabelën e më poshtme (Tabela 2).

Policia					
Lloji i veprës	Neni i Kodit Penal të Kosovës	Numri i Rasteve	Dërguar në Prokurori me kryerës të njohur	Raste nën hetime	Kallëzime penale ndaj këtyre Personave
Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit	339	136	104	32	212
Përvetësim Gjatë Ushtrimit të Detyrës	340	13	7	6	26
Përdorimi i paautorizuar i pasurisë	342	1	1		1
Marrja e Ryshfetit	343	24	23	1	33
Dhënia e Ryshfetit	344	10	10	0	13
Ushtrimi i Ndikimit	345	1	0	1	
Zbulimi i fshehtësive zyrtare	347	1	1		1
Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare	348	4	4	0	5
Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme	349	1	1	0	2
Gjithsejtë:		191	151	40	293

Tabela 2. Të dhënat statistikore për rastet e hetuara për korrupsion nga Policia e Kosovës

Administrata Tatimore e Kosovës

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) gjatë vitit 2011, ka pranuar 23 raste për keq sjellje, neglizhencë, kërcënime, korrupsion, etj. Prej këtyre rasteve, 16 raste janë hetuar nga ZSP-ja (Zyra e sjelljes profesionale), dhe 7 raste janë adresuar në Polici të Kosovës.

ATK po ashtu bënë të ditur se për 68.75% të rasteve të mbyllura ZSP-ja ka rekomanduar masa disiplinore, (zbërthyer në zyrtar i bije për 17 zyrtar të përfshirë në rekomandime për masa disiplinore), ndërsa për 31.25% të rasteve janë dhënë vetëm rekomandime apo kanë rezultuar pa fakte.

Rastet e dyshuar për falsifikim të vërtetimeve tatimor janë dorëzuar në Policin e Kosovës gjegjësisht në drejtorin për krime ekonomike.

Dogant e Republikës së Kosovës

Dogana e Kosovës gjatë vitit 2011, aktivitetet e saj në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, i ka seleksionuar në dy sektor: Sektori për Inspektim të brendshëm doganor, dhe sektori i standardeve profesionale.

Sektori për inspektim të brendshëm doganor gjatë vitit 2011, ka inspektuar në teren, raportuar në procedura disiplinore, dhe ka rekomanduar për përmirësim të sistemit, si në vijim:

- Inspektive në teren: 15;
- Zyrtarë të raportuar në procedura disiplinore: 10; dhe
- Rekomandime për përmirësim të sistemit: 30.

Ndërsa Sektori i standardeve profesionale gjatë vitit 2011, ka raportuar, shqiptuar masa disiplinore, dhe ka proceduar raste në Gjykata apo Polici, si në vijim:

- Raste të raportuara 29;
- Masa disiplinore të shqiptuara 42; dhe
- Raste të proceduara në Gjykata apo Polici 0.

Prokuroria e Republikës së Kosovës

Prokurorit e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2011 kanë punuar në 959 kallëzime penale kundër 1862 personave, të dyshuar për veprime të natyrës korruptive. Prej numrit 959 të kallëzimeve penale sa kanë qenë të trajtuara gjatë vitit 2011, 467 prej tyre janë të trashëguara nga vitet paraprake, ndërsa pjesa tjetër prej 492 janë të pranuar gjatë vitit 2011.

Numri prej prej 959 kallëzimeve penale që janë trajtuar nga Prokuroria e Kosovës gjatë vitit 2011 ato janë zgjidhur në këto mënyra:

- Në 107 raste janë ngritur aktakuza;
- Në 107 raste janë bërë propozim akuzë;
- Në 165 raste janë hedhur kallëzimet penal;
- Në 31 raste kanë pushuar hetimet;
- Në 129 raste kallëzimi penal është zgjidhur në mënyrë tjetër;
- Ndërsa 420 kallëzime penale kanë mbetur për tu zgjidhur në vitin vijues.

Prokuroria

Lloji i veprave sipas Kodit Penal	Është hedhur kallëzimi penal	Ngritja e propozim akuzës	Ngritja e aktakuzave	Pushimi i hetimeve	Kallëzimi penal është zgjidhur në mënyrë tjetër	Kallëzimet e mbetura për vitin vijues
Neni 237- Lidhja e kontratës së dëmshme	2	2	4	3	4	9
Neni 339 - Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit	116	80	84	18	111	310

Neni 340- Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës	7		8	5	5	30
Neni 341 – Mashtrimi në detyrë	2		1			12
Neni 342 – Përdorimi i pa autorizuar i pasurisë					1	
Neni 343 – Marrja e ryshfetit	12	17	5	2	3	19
Neni 344 – Dhënja e ryshfetit	17	7	1	1	1	8
Neni 345 – Ushtrimi i ndikimit			1			1
Neni 346- Nxjerrja e kundër ligjshme e vendimeve gjyqësore	9	1	3	2	4	22
Gjithsejtë:	165	107	107	31	129	421

Tabela 3. Statistikat e zgjidhjes së kallëzimeve penale për rastet përkitazi me korrupsionin në P.K. gjatë vitit 2011.

Prej lëndëve të kallëzimeve penale të trajtuara gjatë vitit 2011, objekt i ndjekjes nga prokurorit e Kosovës gjatë vitit raportues kanë qenë 1046 persona, ndërsa kallëzimet penale kundër 816 personave kanë mbetur të trajtohen në vitin vijues.

- Ndaj 474 personave janë ngritur aktakuza;
- Ndaj 139 personave prokuroria ka bërë propozim akuzë
- Ndaj 216 personave janë hedhur kallëzimet penale;
- Ndaj 71 personave kanë pushuar hetimet
- Ndaj 146 personave kallëzimet penale janë zgjidhur në mënyrë tjetër;
- Ndërsa ndaj 816 personave kallëzimet penale kanë mbetur për tu zgjidhur në vitin vijues.

Prokuroria

Lloji i veprave sipas Kodit Penal	Është hedhur kallëzimi penal	Ngritja e propozim akuzës	Ngritja e aktakuzave	Pushimi i hetimeve	Kallëzimi penal është zgjidhur në mënyrë tjetër	Kallëzimet e mbetura për vitin vijues
Neni 237- Lidhja e kontratës së dëmshme	2	3	12	5	4	13
Neni 339 - Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit	168	108	403	45	119	656
Neni 340- Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës	6		26	5	8	18
Neni 341 – Mashtrimi në detyrë	2		7			4
Neni 342 – Përdorimi i pa autorizuar i pasurisë					3	

Neni 343 – Marrja e ryshfetit	12	19	15	7	3	47
Neni 344 – Dhënja e ryshfetit	19	8	3	4	1	18
Neni 345 – Ushtrimi i ndikimit			1			3
Neni 346- Nxjerrja e kundër ligjshme e vendimeve gjyqësore	7	1	7	5	8	57
Gjithsejtë:	216	139	474	71	146	816

Tabela 4. Statistikat e zgjidhjes së kallëzimeve penale për persona përkitazi me korrupsionin në P.K. gjatë vitit 2011.

Gjykatat e Republikës së Kosovës

Gjykatat e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2011 kanë zgjidhur gjithsejtë 136 lëndë me natyrë korruptive.

Gjykatat gjatë këtij viti kanë gjykuar për këto lloje të veprave korruptive:

1. Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit

Sipas nenit 339 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

- Dhjetë (10) dënime me burgim,
- Trembëdhjetë (13) dënime me gjobë,
- Dymbëdhjetë (12) dënime me kusht,
- Një (1) dënime tjetër
- Pesë (5) Aktgjykim lirues,
- Tre (3) aktgjykim refuzues, dhe
- Njëzet e një (21) janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

2. Përvetësim Gjatë Ushtrimit të Detyrës

Sipas nenit 340 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

- Tre (3) dënime burgim,
- Katër (4) dënime me kusht, dhe
- Katër (4) janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

3. Mashtrimi në detyrë

Sipas nenit 341 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

- Një (1) dënime me kusht.

4. Përdorim i Paautorizuar i Pasurisë

Sipas nenit 342 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

- Një (1) dënime me burg,
- Një (1) dënime me kusht, dhe
- Një (1) Aktgjykim lirues.

5. Marrja e Ryshfetit

Sipas nenit 343 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

- Pesë (5) dënime me burg,
- Tre (3) dënime me gjobë,
- Tre (3) dënime me kusht
- Një (1) Aktgjykim lirues
- Dy (2) janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

6. Dhënia e Ryshfetit

Sipas nenit 344 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

- Njëzet (20) dënime me gjobë,
- Dy (2) dënime me kusht, dhe
- Një (1) është zgjidhur në mënyrë tjetër.

7. Ushtrimi i Ndikimit

Sipas nenit 345 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

- Një (1) dënime me gjobë, dhe
- Një (1) dënime me kusht.

8. Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve Gjyqësore

Sipas nenit 346 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

- Një (1) dënime me gjobë, dhe
- Një (1) është zgjidhur në mënyrë tjetër

9. Zbulimi i fshehtësive zyrtare

Sipas nenit 347 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

- Një (1) dënime me gjobë, dhe
- Dy (2) janë zgjidhur në mënyrë tjetër

10. Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare

Sipas nenit 348 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

- Një (1) dënime me burg,
- Pesë (5) dënime me gjobë,
- Një (1) aktgjykim lirues, dhe
- Dy (2) janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

11. Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme

Sipas nenit 349 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

- Një (1) dënime me gjobë, dhe
- Një (1) është zgjidhur në mënyrë tjetër

12. Lirimi i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria

Sipas nenit 350 të Kodit Penal të Kosovës, Gjykatat e Kosovës i kanë shqiptuar këto aktgjykime:

- Një (1) dënime me kusht

Këto të dhëna statistikore janë paraqitur edhe në tabelën e më poshtme (Tabela 5).

Gjykatat									
Lloji i veprës	Neni i Kodit Penal të Kosovës	Dënim me Burg	Dënim me Gjobë	Dënim me Kusht	Dënim tjetër	Aktgjykim Lirues	Aktgjykim Refuzues	Të zgjidhur në mënyrë tjetër	Gjithsejtë Lëndë të zgjidhura
Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit	339	10	13	12	1	5	3	21	65
Përvetësim Gjatë Ushtrimit të Detyrës	340	3	0	4	0	0	0	4	11
Mashtrimi në Detyrë	341	0	0	1	0	0	0	0	1
Përdorim i Paautorizuar i Pasurisë	342	1	0	1	0	1	0	0	3
Marrja e Ryshfetit	343	5	3	3	0	1	0	2	14
Dhënia e Ryshfetit	344	0	20	2	0	0	0	1	23
Ushtrimi i Ndikimit	345	0	1	1	0	0	0	0	2
Nxjerrja e Kundërligjshme e vendimeve Gjyqësore	346	0	1	0	0	0	0	1	2
Zbulimi i Fshehtësive Zyrtare	347	0	1	0	0	0	0	2	3
Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare	348	1	5	0	0	1	0	2	9
Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme	349	0	1	0	0	0	0	1	2
Lirimi i Kundërligjshëm i Personit nga Liria	350	0	0	1	0	0	0	0	1
Gjithsejtë:		20	45	25	1	8	3	34	136

Tabela 5. Të dhënat statistikore të gjykimeve që janë shqiptuar nga Gjykatat e Kosovës për rastet korruptive gjatë vitit 2011

Analiza

Agjencia kundër Korrupsionit, gjatë vitit raportues 2011 ka ushtruar 39 kallëzime penale, kundër 121 personave. Në këto raste të ndjekjes kanë qenë të angazhuar 11 zyrtar të Agjencisë konkretisht nga Drejtoria për Luftimin e Korrupsionit.

Dogana e Kosovës, gjatë vitit raportues 2011, nëpërmes dy sektorëve (Sektori për Inspektimin e brendshëm, dhe Sektori për standarde profesionale) i ka realizuar disa aktivitete, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit. Në këtë drejtim janë shqiptuar disa masa disiplinore, si dhe janë dhënë disa rekomandime për përmirësimin e performancën e stafit. Kallëzime penale nga ky institucion nuk janë raportuar.

Administrata Tatimore e Kosovës, në angazhimet e saja kundër korrupsionit ka trajtuara disa raste për: keq sjellje, neglizhencë, kërcënim, dhe korrupsion. Pas trajtimeve të rasteve masat e propozuara janë të natyrës disiplinore dhe rekomanduese. Është raportuar një rast i mashtrimit, i cili i takon vitit 2010, ndërsa gjatë vitit 2011 nuk ka pasur asnjë rast.

Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion, i ka përcjell në prokuroritë kompetente 151 raste, kundër 293 personave. Kjo drejtori ka një staf prej 120 zyrtarëve.

Në vijim në formë tabelare pasqyrohet numri i kallëzimeve penale që institucionet e lartë përmendura i kanë adresuar tek prokurorit kompetente.

Kallëzimet penale		
Institucioni:	Numri i rasteve:	Numri i personave
Agjencia kundër Korrupsionit	39	121
Policia e Kosovës	151	293
Dogana e Kosovës	0	0
Administrata Tatimore	0	0
Gjithsejtë:	190	414

Tabela 6. Kallëzimet penale nga AKK, PK, DK, ATK

Prokuroritë e Republikës së Kosovës, gjatë vitit raportues 2011 kanë bërë 107 propozim akuza, kundër 139 personave, dhe 107 akuza, kundër 474 personave. Caktimi i koordinatoreve kundër korrupsion në të gjitha prokuroritë e Kosovës është një e arritur pozitive.

Në vijim në formë tabelare pasqyrohet numri i propozim akuzave dhe akuzave të ngritura nga Prokurorit e Kosovës.

Prokuroritë e Kosovës		
	Numri i rasteve	Numri i personave
<i>Propozim akuza</i>	107	139
<i>Akuza</i>	107	474
<i>Gjithsejtë:</i>	214	613

Tabela7. Akuzat dhe propozim akuzat nga Prokuroritë

Gjykatat e Kosovës, gjatë vitit raportues i kanë zgjidhur gjithsejtë 136 lëndë. Prej tyre në 20 raste janë shqiptuar dënime me burg, 45 dënime me gjobë, 25 dënime me kusht, 1 dënim tjetër, 8 aktgjykime liruese, 3 aktgjykime refuzuese, 34 të zgjidhura në mënyrë tjetër.

Në vijim në formë tabelare pasqyrohet numri i rasteve të zgjidhura nga gjykatat

Dënimet e shqiptuara nga Gjykatat					
	Me Burg	Me Gjobë	Me kusht	Të tjera	Gjithsejtë
<i>Gjykatat Komunale</i>	14	45	22	1	82
<i>Gjykatat e Qarkut</i>	6	0	3	0	9
<i>Gjithsejtë:</i>	20	45	25	1	91

Tabela 8. Dënimet e shqiptuara nga Gjykatat e Kosovës

Karakteristikat e përgjithshme të veprave të natyrës korruptive për të cilat është ushtruar kallëzim penal.

Veprat penale	AKK	Policia	Gjithsejtë
Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit (339)	33	104	137
Përvetësimi gjatë Ushtrimit të Detyrës (340)	0	7	7
Mashtrimi në detyrë (341)	1	0	1
Përdorimi i Paautorizuar i Pasurisë (342)	0	1	1

Marrja e Ryshfetit (343)	0	23	23
Dhënia e Ryshfetit (344)	0	10	10
Nxjerrja e Kundërligjshme e Vendimeve Gjyqësore (346)	2	0	2
Zbulimi i Fshtësive Zyrtare (347)	0	1	1
Falsifikimi i Dokumenteve Zyrtare (348)	0	4	4
Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme (349)	1	1	2
Shmangia nga Tatimi (249)	1	0	1
Vjedhja (252)	1	0	1
Gjithsejtë:	39	151	190

Tabela 9. Kallëzimet penale të AKK-së, dhe PK sipas llojit të veprës

Ngritja e akuzave sipas natyrës së veprës

Ngritja e akuzave dhe propozim akuzave nga prokuroritë			
Veprat penale:	Propozim akuzë	Akuzë	Gjithsejtë
Lidhja e kontratës së dëmshëm (237)	2	4	6
Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit (339)	80	84	164
Përvetësimi gjatë Ushtrimit të Detyrës (340)	0	8	8
Mashtrimi në detyrë (341)	0	1	1
Përdorimi i Paautorizuar i Pasurisë (342)			
Marrja e Ryshfetit (343)	17	5	22
Dhënia e Ryshfetit (344)	7	1	8
Ushtrimi i Ndikimit (345)	0	1	1
Nxjerrja e Kundërligjshme e Vendimeve Gjyqësore (346)	1	3	4
Gjithsejtë:	107	107	214

Tabela 10. Ngritja e akuzave dhe propozim akuzave nga prokuroritë, sipas llojit të veprave

Siç po shihet edhe nga tabela e më sipërme prokurorit e Kosovës kanë ngritur 107 akuza si dhe kanë bërë 107 propozim akuza.

Tabela në vijim pasqyron shqiptimin e dënimeve nga ana e gjykatave sipas llojit të veprës.

Gjykimet					
Veprat penale	Dënim me burg	Dënim me gjobë	Dënim me kusht	Dënim tjetër	Gjithsejtë
Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit (339)	10	13	12	1	36
Përvetësimi gjatë Ushtrimit të Detyrës (340)	3	0	4	0	7
Mashtrimi në detyrë (341)	0	0	1	0	1
Përdorimi i Paaautorizuar i Pasurisë (342)	1	0	1	0	2
Marrja e Ryshfetit (343)	5	3	3	0	11
Dhënia e Ryshfetit (344)	0	20	2	0	22
Ushtrimi i Ndikimit (345)	0	1	1	0	2
Nxjerrja e Kundërligjshme e Vendimeve Gjyqësore (346)	0	1	0	0	1
Zbulimi i Fshtësive Zyrtare (347)	0	1	0	0	1
Falsifikimi i Dokumenteve Zyrtare (348)	1	5	0	0	6
Arkëtimi dhe Pagesa e Paligjshme (349)	0	1	0	0	1
Lirimi i kundërligjshëm i Personit të Privuar nga Liria (350)	0	0	1	0	1
Gjithsejtë:	20	45	25	1	91

Tabela 11. Gjykimet sipas llojit të veprave penale

Ky raport përtej të dhënave statistikore dhe analizës së hetimeve dhe ndjekjes së veprimeve penale të natyrës korruptive gjatë vitit 2011, pasqyron edhe krahasimin e punës në mes të viteve 2010-2011 të të gjitha institucioneve të përfshira në këtë raport.

Tabela në vijim pasqyron numrin e kallëzimeve penale dhe personave të atakuar në to krahasuar në mes të viteve 2010 dhe 2011

Vitet:	Kallëzime penale		Personat e përfshirë	
	2010	2011	2010	2011
AKK	29	39	101	121
Policia	282	151	368	293
Dogana	5	0	5	0
ATK	0	0	0	0

Tabela 12. Rastet e dërguara në prokurori gjate viteve 2010/2011

Në vitin 2010 prokurorit e Kosovës raportet i kanë nxjerrë vetëm duke ju personave të përfshirë në kallëzime penale e jo rasteve. Prandaj tabela 13 nuk pasqyron numrin e rasteve për vitin 2010.

Tabela në vijim pasqyron numrin e propozim akuzave dhe akuzave nga ana e prokurorive të vendit sipas rasteve dhe personave të atakuar krahasuar në mes vitit 2010 dhe 2011.

Propozim akuza dhe akuza nga Prokuroritë				
	2010		2011	
	Raste	Persona	Raste	Persona
Propozim akuza	-	346	107	139
Akuza	-	184	107	477

Tabela 13. Propozim akuza dhe akuza të ngritura nga prokuroritë gjatë vitit 2010/2011

Tabela në vijim pasqyron numrin e gjykimeve dhe shqiptimin e dënimeve nga ana e Gjykatave të vendit të krahasuara në mes vitit 2010 dhe 2011.

Gjykimet		
	2010	2011
Me burg	6	20
Me gjobë	29	45
Me kusht	24	25

Tjera	2	1
Gjithsejtë:	61	91

Tabela 14. Gjykimet e shqiptuara nga gjykatat gjatë viteve 2010 dhe 2011

Konkluzionet

Nga të dhënat statistikore rezulton se numri më i madh i veprave penale të karakterit korruptiv i takon Veprës penale, Shpërdorimi i detyrës zyrtare. Për këtë lloj vepre janë ngritur 80 propozim akuza dhe 84 aktakuza, ndërsa janë shqiptuar 10 dënime me burg, 13 dënime me gjobë dhe 12 dënime me kusht.

Për më tej ndryshe nga vitet paraprake gjatë vitit 2011 bashkëpunimi ndërinstitutional është forcuar dhe raportet bashkëpunuese në mes të të gjitha institucioneve që kanë për mision luftën kundër korrupsionit ka shënuar një avancim të dukshëm. Kjo shihet edhe nga të dhënat tabelare ku funksionimi i zingjirit ndjekës është më funksional me faktin se numri i shqiptimit të dënimeve është rritur për rreth 50% në krahasim me vitin 2010. Dhe kjo duket të jetë falë bashkëpunimit më efikas ndërinstitutional.

Mësimet dhe Rekomandimet

1. Rekomandohet që të gjitha këto institucione ta bëjnë unifikimin e listës së cilësimit të veprave penale me karakter korruptiv duke u mbështetur në Kodin Penal të Kosovës. Do të ishte mirë që të gjitha këto institucione të qartësojnë në mënyrë unike se cilat vepra janë të karakterit korruptiv. A janë vetëm ato që kanë të bëjnë me veprat penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare nga kapitulli XXIX të Kodit Penal apo edhe veprat tjera.
2. Për të pasur një pasqyrë më të saktë për të gjitha rastet korruptive dhe informacionin e nevojshëm për gjithë procesin e hetimit të rasteve, rekomandohet që sa më shpejtë që është e mundur të krijohet një bazë e të dhënave, në të cilën do të futen të dhënat për rastet e dyshuara korruptive nga të gjitha këto institucione, Agjencia, Policia, Doganat, Prokuroria dhe Gjykatat. Kësisoj do të jepet një pasqyrë shumë reale për gjithë procesin hetues të rasteve korruptive;
3. Të evidentohen me saktësi të dhënat statistikore në mes Prokurorisë dhe Gjykatave. Kjo për faktin se Prokuroritë lëndët i adresojnë tek gjykatat të evidentuara si raste dhe po ashtu numër të personave të akuzuar, kurse gjykatat raportojnë vetëm për numrin e zgjidhjes së rasteve pa ndonjë evidencë se sa persona janë gjykuar.
4. Për të pasqyruar më saktë se në çfarë mase po gjykohet korrupsioni është shumë e nevojshëm që gjykatat të mbajnë evidencë dhe të publikojnë lartësinë e dënimeve.

Lista e tabelave:

TABELA 1. TË DHËNAT STATISTIKORE PËR RASTET E HETUARA PËR KORRUPSION DHE TË PËRCJELLA NË ORGANET KOMPETENTE PËR PROCEDIM TË MËTUTJESHËM PENAL NGA AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT.	4
TABELA 2. TË DHËNAT STATISTIKORE PËR RASTET E HETUARA PËR KORRUPSION NGA POLICIA E KOSOVËS....	6
TABELA 3. STATISTIKAT E ZGJIDHJES SË KALLËZIMEVE PENALE PËR RASTET PËRKITAZI ME KORRUPSIONIN NË P.K. GJATË VITIT 2011.	8
TABELA 4. STATISTIKAT E ZGJIDHJES SË KALLËZIMEVE PENALE PËR PERSONA PËRKITAZI ME KORRUPSIONIN NË P.K. GJATË VITIT 2011.	9
TABELA 5. TË DHËNAT STATISTIKORE TË GJYKIMEVE QË JANË SHQIPTUAR NGA GJYKATAT E KOSOVËS PËR RASTET KORRUPTIVE GJATË VITIT 2011	11
TABELA 6. KALLËZIMET PENALE NGA AKK, PK, DK, ATK.....	12
TABELA 7. AKUZAT DHE PROPOZIM AKUZAT NGA PROKURORITË	13
TABELA 8. DËNIMET E SHQIPTUARA NGA GJYKATAT E KOSOVËS	13
TABELA 9. KALLËZIMET PENALE TË AKK-SË, DHE PK SIPAS LLOJIT TË VEPRËS	14
TABELA 10. NGRITJA E AKUZAVE DHE PROPOZIM AKUZAVE NGA PROKURORITË, SIPAS LLOJIT TË VEPRAVE	14
TABELA 11. GJYKIMET SIPAS LLOJIT TË VEPRAVE PENALE	15
TABELA 12. RASTET E DËRGUARA NË PROKURORI GJATE VITEVE 2010/2011	16
TABELA 13. PROPOZIM AKUZA DHE AKUZA TË NGRITURA NGA PROKURORITË GJATË VITIT 2010/2011	16
TABELA 14. GJYKIMET E SHQIPTUARA NGA GJYKATAT GJATË VITEVE 2010 DHE 2011	17

[! Klike këtu për t'u kthyer në fillim të raportit](#)

Agjencia kundër Korrupsionit

Rr. Nazim Gafurri, Nr.31 Prishtinë 10000 Kosovë

Tel: +381(0)38 518-987; Fax: +381(0)38 518-977

Web: www.akk-ks.org